



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

VENDIM

K.P.P. 125/2020

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 02.04.2020, shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimin e vendimit të KVO-së për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “V.A.L.E. Recycling” sh.p.k., në procedurën e prokurimit “Kërkesë për propozim – Marrëveshje kuadër”, me objekt “Trajtimi i mbetjeve të rrezikshme spitalore, anatomike të lëngëta dhe të ngurta” për QSUNT, për 12 muaj”, me nr. REF-45894-12-10-2019, me vlerë të pritshme të kontratës 2,700,000 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 30.12.2020, nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Medi - Tel” sh.p.k., në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Ankimues: Operatori ekonomik “V.A.L.E. Recycling” sh.p.k.
Adresa: Afër ish-kanalit të acidit, Gurëz, Fushë Kuqe, Lezhë.

Autoriteti Kontraktor: Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”
Adresa: Rruga e Dibrës, Nr. 372, Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës dhe të dokumentacionit të dërguar nga ankimuesi dhe autoriteti kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se, mbështetur në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ankimuesi ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.2. Ankimuesi ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe, më pas, ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.

I.3. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës të operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 11.12.2019, në sistemin e prokurimeve elektronike është publikuar procedura e prokurimit, “Kërkesë për propozim – Marrëveshje kuadër”, me objekt “Trajtimi i mbetjeve të rrezikshme spitalore, anatomike të lëngëta dhe të ngurta” për QSUNT, për 12 muaj”, me nr. REF-45894-12-10-2019, me vlerë të pritshme të kontratës 2,700,000 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 30.12.2020, nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.

II.2. Në datën 13.01.2020, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

- | | |
|--------------------------------|-------------------------------|
| 1. “V.A.L.E Recycling” sh.p.k. | 2,070,000 lekë, Kualifikuar; |
| 2. “Pura - Medical” sh.p.k. | 2,160,000 lekë, Skualifikuar; |
| 3. “Medi - Tel” sh.p.k. | 2,520,000 lekë, Kualifikuar; |
| 4. “Ecoriciklim” sh.p.k. | 2,700,000 lekë, Kualifikuar; |

II.3.Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, rezulton se në datën 16.01.2020, operatori ekonomik "Medi - Tel" sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik "V.A.L.E Recycling" sh.p.k. në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi. Ankesa e mësipërme është pranuar nga komisioni i shqyrtimit të ankesave.

II.4. Në datën 23.01.2020, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e rivlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

- | | |
|--------------------------------|-------------------------------|
| 1. "V.A.L.E Recycling" sh.p.k. | 2,070,000 lekë, Skualifikuar; |
| 2. "Pura - Medical" sh.p.k. | 2,160,000 lekë, Skualifikuar; |
| 3. "Medi - Tel" sh.p.k. | 2,520,000 lekë, Kualifikuar; |
| 4. "Ecoriciklim" sh.p.k. | 2,700,000 lekë, Kualifikuar; |

II.5.Me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorin ekonomik "V.A.L.E Recycling" sh.p.k. për skualifikimin e ofertës së tij, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, me arsyetimin si më poshtë vijon:

"Ne baze te Vendimit nr.424/3 prot.,date 21.01.2020 te AK, Operatori Ekonomik skualifikohet nga procedura me objekt "Trajtimi i Mbetjeve Spitalore anatomike te lengeta dhe te ngurta per QSUNT per 12- muaj" per shkak se oferta e paraqitur nga ky OE nuk permbush kerkesat e DST, PIKA 2.3 "Per kapacitetin teknik" germa c. Landfilli i Bushatit (menaxhim i te cilit behet nga Subjekti BECKER ALBANIA) me te cilin OE "V.A.L.E Recycling"sh.p.k ka nenshkruar kontate per depozitimin e mbetjeve spitalore asgjesim i te cilave behet me incenerim nuk eshte i pajisur me leje mjedisore konform legjislacionit ne fuqi."

II.6. Në datën 27.01.2020, operatori ekonomik "V.A.L.E Recycling" sh.p.k. ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij, si dhe duke ngritur pretendime mbi ofertën e paraqitur nga operatori ekonomik "Medi - Tel" sh.p.k., në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, me argumentimin si më poshtë vijon:

"[...]. Në mesazhin e arsyeve të skualifikimit në po të njëjtën datë, na bëhet me dije se jemi skualifikuar me arsyet si vijon: Ne baze te Vendimit nr.424/3 prot.,date 21.01.2020 te AK, Operatori Ekonomik skualifikohet nga procedura me objekt "Trajtimi i Mbetjeve Spitalore anatomike te lengeta dhe te ngurta per QSUNT per 12- muaj" per shkak se oferta e paraqitur nga ky OE nuk permbush kerkesat e DST, PIKA 2.3 "Per kapacitetin teknik" germa c. Landfilli i Bushatit (menaxhim i te cilit behet nga Subjekti BECKER ALBANIA) me te cilin OE "V.A.L.E Recycling" sh.p.k ka nenshkruar kontrate per depozitimin e mbetjeve spitalore asgjesim i te cilave behet me incenerim nuk eshte i pajisur me leje mjedisore konform legjislacionit ne fuqi."

Nga mesazhi i mësipërm, rezulton qartë se rivlerësimi është bërë pasi është pranuar ankesa e Operatorit Ekonomik MEDI TEL, i cili është operatori i kualifikuar që vjen menjëherë pas oferëts sonë. Kjo, arsye skualifikimi nuk qëndron. Kriteri në fjalë, pika 2.3 "Per kapacitetin teknik", gërma c, i cili pretendohet që nuk është përmbushur nga ana jonë, lexon si vijon: "c) Te kete leje nga Bashkia per depozitimin e produkteve që dalin nga përpunimi". Pra qëllimi i këtij kriteri është që AK të sigurohet që pasi mbetjet anatomike të asgjësohen në impiantin e incenerimit, produkti i mbetur nga procesi i incenerimit, që konsiderohet mbetje e parrezikshme pas trajtimit, të depozitohet / evadohet sipas të gjitha rregullave dhe ligjeve në fuqi. Si të gjithë OE të tjerë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, përfshirë edhe ankimesi OE MEDI-TEL, edhe ne kemi

paraqitur kontratën përkatëse me landfillin përkatës që pranon për landfillim mbetjet/produktet që dalin nga përpunimi në impiantin tonë i mbetjeve Spitalore. Më konkretisht ne kemi depozituar në SPE dokumentin “Kontrata landfilli dhe leje Becker.pdf” me 27 faqe, që përbëhet nga:

1. Kontrata e lidhur nga V.A.L.E Recycling sh.p.k. me Ndërkomunale Bushat sh.a. nr.55, datë 21.03.2019

2. Kontrata ndërmjet Ndërkomunale Bushat sh.a. dhe Shoqërisë “Becker Albania” sh.a. datë 28.04.2017 ku Ndërkomunale Bushat si pronar i landfillit të Bushatit, angazhon Becker Albania që është i pajisur me Leje Mjedisore, si operator i landfillit të Bushatit. Në këtë kontratë, në pjesën Preambula, në pikën iv është përcaktuar që: “ish Keshilli i Komunes Bushat, (sot Bashkia Vau Dejes) si aksionar i vetëm i Porositesit’, me Vendimin Nr.25 date 11.06.2010 ka miratuar dhenien ne perdorim te lendfillit te Komunes Bushat shoqerise "Becker Albania" sh.a. dhe ka autorizuar lidhjen e kontrates perkatese për realizimin e shërbimeve të depozitimit, administrimit, menaxhimit, përpunimit dhe riciklimit të mbetjeve. ”

3. Leja Mjedisore dhe Akt Miratimi përkatës Nr. PN-1234-12-2010, e lëshuar për shoqërinë Becker Albania për operimin e venddepozitimit të mbetjeve (landfillin) të Bushatit.

Nga as më sipër duket qartë se kriteri i vendosur nga AK, jo vetëm është përmbushur, por dokumentacioni i paraqitur tejkalon edhe vetë kërkesat e AK, pasi provon me dokumentacion të gjithë zinxhirin e mbulimit të këtij kriteri. Pra, Ndërkomunale Bushat sh.a. që është një shoqëri publike me aksioner të vetëm vetë Bashkinë Vau i Dejës, ka në pronësi venddepozitimin e mbetjeve të Bushatit dhe në objektin e veprimtarisë së saj ka përcaktuar që do të mbulojë Qarkun e Shkodrës dhe një pjesë të Qarkut të Lezhës ku përfshihet dhe vendi i ushtrimit të aktivitetit të V.A.L.E Recycling. Vetë Bashkia Vau i Dejës, ka autorizuar që për Operimin e landfillit, Ndërkomunale Bushat të angazhojë shoqërinë Becker Albania dhe përveç kontratës së lidhur mës këtyre dy subjekteve ne kemi paraqitur edhe Lejen Mjedisore përkatëse të Becker Albania. Sidoqoftë, kjo çështje identike është zgjidhur njëherë nga KPP me Vendimin nr.329/2019, sërish në bazë të një ankese të paraqitur nga OE MEDI-TEL, dhe KPP në këtë Vendim është shprehur se:

III.5.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se në përmbushje të kriterit sa më sipër operatori ekonomik “Vale Recycling” shpk ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Kontratë Shërbimi datë 18.04.2017 lidhur ndërmjet shoqëria Ndërkomunale Bushat sha në cilësinë e porositesit dhe shoqëria Becker Albania sha në cilësinë e operatorit me objekt: Objekti i kësaj kontrate është përcaktimi i kushteve midis palëve për dhënien në përdorim të landfillit të bushatit, operatorit dhe realizimit prej tij të shërbimeve të depozitimit, administrimit, menaxhimit, përpunimit dhe riciklimit të mbetjeve të ngurta urbane në landfillin e bushatit. Shërbimet e depozitimit, administrimit , menaxhimit përpunimit dhe riciklimit të mbetjeve të ngurta urbane në landfillin e bushatit merren përsipër të kryhen prej operatorit në përmbushje të kushteve të kësaj kontrate.

- Leje Mjedisore Kodi III.1.B për aktivitetin e funksionimit të venddepozitimit të mbetjeve urbane në emër të Becker Albania. Akt Miratimi Leje Mjedisore Nr.7185/4 datë 15.12.2010

- Kontratë Nr.55 prot datë 21.03.2019 lidhur ndërmjet Ndërkomunale Bushat sha dhe Vale Recycling shpk . Shoqëria dhe Klienti dëshirojnë të hyjnë në një marrëdhënie kontraktuale në të cilën shoqëria pranon të depozitohen beturinat urbane të praueshme në landfill nga ose në emër të klientit dhe klienti do të lëvrojë një sasi kontraktuale të mbeturinave urbane të pranueshme dhe do të paguajë shoqërinë për depozitimin e këtyre mbeturinave.

III.5.3. Në nenin 46, pika 1, gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti

kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.” Aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

III.5.4. Neni 53 pika 3 e Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.

III.5.5. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërituar, KPP gjykon se operatori ekonomik “Vale Recycling” shpk ka dorëzuar në përputhje me kriterin kualifikues dokumentacion lidhur me një landfill të licensuar nga organet kompetente shtetërore, për depozitimin e produktit final që del nga përpunimi i mbetjeve spitalore. KPP gjykon se operatori ekonomik ka përmbushur kërkesat në kriterin e vecantë të kualifikimit duke dëshmuar se disponon një landfill në një nga format e lejuara ligjore për depozitimin e produktit final.

Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik “Medi Tel” shpk nuk qëndron

Thënë sa më sipër, na mbetet vetëm të dyshojmë se AK ka pranuar ankesën e OE MEDI-TEL për skualifikimin tonë, duke e favorizuar këtë operator që për më tepër ka ofruar edhe cmim më të lartë se Oferta e paraqitur prej nesh. Duke na skualifikuar në mënyrë të sforcuar pra, çënohen jo vetëm të drejtat tona dhe barazia në trajtim, por edhe rrezikohet të dëmtohet buxheti i shtetit.

2. Trajtimi favorizues për OE MEDI -TEL.

Na rezulton se OE MEDI-TEL është kontraktori aktual i QSUT për evadimin e mbetjeve spitalore. Sidoqoftë, na duhet të sjellim në vëmendjen tuaj, që ndërkohë që ky OE ngre pretendime të pabazuara ligjore për kualifikimin tonë, vetë ky OE nuk përmbush kriterin kryesor për kualifikim në këtë procedurë dhe pikërisht pikën 2.1.a për kapacitetin ligjor: “Leje mjedisore e tipit A e leshuar nga Ministria e Mjedisit. (Kodi III.1.C)” e lidhur me pikën 3 të Specifikimeve Teknike: “Asgjesimi duhet të realizohet me një prej metodave për trajtimin dhe asgjësimin e mbetjeve spitalore të përcaktuara në VKM Nr. 798, datë 29. 09.2010. Shtojca 3 e këtij vendimi parashikon se mbetjet e rrezikshme spitalore anatomike, të lengeta dhe të ngurta duhet të trajtohen me incenerim ” dhe pikën 2.1.b për kapacitetin ligjor “Licencë me kodin III.2.B.

OE MEDI TEL, në Lejen Mjedisore të Tipit A (Kodi III.1.C) me numër PN-3194-06-2016 me Nr. 4203 Prot, datë 27.06.2016, të Komisionit Nr.21, me Nr. i identifikimit të Lejes 2193, nuk ka të lejuara të trajtojë mbetjet anatomike me kodin 18 01 02 me metodën e incenerimit, madje nuk ka të lejuara të trajtojë asnjë nga mbetjet spitalore të kujdesit për njerëzit që përfshihen nën kodet 18 01. Kjo verifikohet lehtësisht nga mungesa e këtyre kodeve në Tabelat 4.1.1. dhe 4.1.2. të Akt Miratimit të Lejes Mjedisore (fq.34 - 36). Edhe Licensa me kod III.2.B e disponuar nga OB MEDI-TEL për

metoden e incenerimit, percakton ndër kushtet e saj që: “a. Të respektojë kushtet për mbrojtjen e mjedisit sipas përcaktimeve në Lejen Mjedisore PN-3194-06-2016 me Nr. 4203 Prot, datë 27.06.2016, të Komisionit Nr.21, me Nr. i identifikimit të Lejes 2193.”. Për sa kohë, kjo Leje Mjedisore me Nr. identifikimi 2193, nuk e lejon operatorin në fjalë të trajtojë kodin 18 01 02, por edhe asnjë nga kodet e nëngrupit 18 01 me metoden e incenerimit, atëhere as licenca e tij nuk është e zbatueshme për këto kode. Nga sa më sipër rezulton se AK, jo vetëm po tenton të na skualifikojë në pa të drejtë, por edhe ka neglizhuar në shqyrtimin e dokumentacionit të OE MEDI-TEL, madje edhe në monitorimin e zbatimit të kontratës paraardhëse prej këtij operatori, duke krijuar kështu mundësinë që ky OE të bëjë një nga shkeljet më të rënda që është operimi pa lejen dhe licensën përkatëse, për më tepër në një fushë kaq sensitive për jetën shëndetin dhe mjedisin sic janë trajtimi i mbetjeve spitalore. Në konkluzion, duke u nisur nga sa më sipër, kërkojmë shqyrtimin e ankesës sonë dhe rivlerësimin përkatës, duke na kualifikuar dhe duke e pranuar ofertën tonë si të vlefshme. Gjithashtu, kërkojmë të merret në konsideratë fakti, se OE MEDI-TEL, aktualisht operon pa pasur në Lejen Mjedisore të tipit A, lejimin për trajtimin me metodën e incenerimit të mbetjeve anatomike me kod 18 01 02. Ky OE është në shkelje flagrante të ligjit dhe në vend të denoncohet nga ana juaj në organet inspektuese dhe ligjzbatuese për këtë shkelje të rëndë, ai kualifikohet, krejt ndryshe nga ne që skualifikohemi edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kriteret dhe kemi ofruar vlerën më të ulët.[...]”

II.7. Nga verifikimet e kryera në dokumentacionin e paraqitur pranë KPP, me anë të shkresës Nr. 594/4 Prot. datë 03.02.2020, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues “V.A.L.E Recycling” sh.p.k., duke mos e pranuar ankesën e paraqitur prej tij, me arsyetimin si më poshtë vijon:

”[...] Ankuesi OE “VALE RECYCLING” ShPK, në lidhje me procedurën objekt ankimi, pas shpalljes së rivlerësimit nga AK në SPE me datë 23.01 .2020, ka ushtruar të drejtën ligjore të ankimit brenda afatit të parashikuar në nenit 63, pika 2 të LPP(Formular i ankesës Nr. 594/2 prot date 29.01.2020.) AK QSU “Nënë Tereza” Tiranë me datë 11.12.2019, ka publikuar në sistemin e APP-së procedurën e prokurimit me objekt: Trajtimi i mbetjeve të rrezikshme spitalore anatomike të lëngëta dhe të ngurta“ për QSUNT për 12 muaj”, me Fond Limit/Vlerë të pritshme të kontratave 2 700 000 (Dy milion e shtatëqind mijë) lekë pa TVSH dhe 3 240 000 (Tre milion e dyqind e dyzetë mijë) lekë me TVSH vene ne dispozicion nga Buxheti i Shtetit, të publikuar me REF-45894-12-10-2019; Për këtë arsye AK ka plotësuar dokumentet standarde të tenderit, ku në zbatim të parashikimeve të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, dhe VKM 914/2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, si dhe aktet nënligjore të APP, ka përcaktuar edhe kriteret kualifikuese që duhet të plotësojë çdo operator ekonomik në mënyrë që oferta financiare të kualifikohet si ofertë e vlefshme. Për sa i përket pretendimeve të OE ankimes, në zbatim të parashikimeve të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, VKM 914/2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, KSHA vlerëson se: Ne DST per kete objekt prokurimi, sa i perket Shtojccs Nr.7/Kriteret per kualifikimin e OE, kapaciteti teknik citohet :

2.1. Për kapacitetin ligjor/profesional: Ofertuesi duhet te paraqese dokumentat e kerkuara ne kriteret e pergjithshme te pranimit/kualifikimit.

a) Leje mjedisore e tipit A e lëshuar nga Ministria e Mjedisit. (Kodi III.I.C)

b) Licence per Veprimtaritë e tjera profesionale lidhur me ndikimin në mjedis (Kodi III.2.B)

Ne lidhje me përmbushjen e këtij kriteri, nga verifikimi rezulton se OE MEDITEL ka ngarkuar në SPE dokumentacionin si më poshtë:

-Leje mjedisore tipi A (Nr. 4203 prot date 27.06.2016) Kodi III.1.C Pershkrim i veprimtarise: Instalim i mbetjeve te rrezikshme ne një sistem incenerimi, incenerim i mbetjeve duke përfshire mbetjeve te kafshëve ne nje instalim incenerimi

- Leje mjedisore tipi B (Nr. 2959 prot date 13.04.2018)Kodi III.1.B Pershkrim i veprimtarise: Asgjësim i mbetjeve te rrezikshme përveç incenerimit ose landfillimit

- License e kategorise III.2.B (Nr. 9043 prot date 22.10.2019) Pershkrim i aktivitetit te licencuar: Grumbullim, depozitim, trajtim, asgjësim i mbetjeve te rrezikshme dhe jo te rrezikshme me metoden incenerim (Kodet 18 01, 18 02, 20 01, 20 02, 20 03) ;

-Licence e kategorisë III.2.B(Nr. 9561 prot datë 08.11 2019) Përshkrim i aktivitetit te licencuar: Grumbullim, transportim, ruajtje, trajtim dhe asgjësim i mbetjeve te rrezikshme spitalore (Kodet 180101, 180102, 180103, 180104, 180201, 180202, 180203,190305, 190307).

Sa me siper, lidhur me pretendimin e operatorit ankimues “VALE RECYCLING ShPK qe operatori MEDITEL ShPK operon pa pasur ne lejen mjedisore te tipit A, lejimin për trajtimin me metodën e incenerimit te mbetjeve anatomike me kod 18 01 02, pas verifikimeve ne dokumentacionin e administruar nga KVO, si edhe verifikimeve ne SPE, rezulton qe operatori MEDI TEL disponon dokumentacionin e duhur për përmbushjen e kriterëve teknike/ligjore sa i perket këtij kriteri (specifikisht dokumenti Nr. 95 61 prot date 08.11.2019 Licence e kategorisë III. 2.B Përshkrim i aktivitetit te licencuar:Grumbullim, transportim, ruajtje, trajtim dhe asgjësim i mbetjeve te rrezikshme spitalore (Kodet 18 01 01, 18 01 02, 18 01 03, 18 01 04, 18 02 01, 18 02 02, 18 02 03, 19 03 05, 19 03 07) ”Nga vlerësimi i dokumentacionit të administruar KSHA vlerëson se OE MEDI TEL përmbush kërkesat e pikës 2.1 'Për kapacitetin ligjor profesional Pika a) Leje mjedisore e tipit A e lëshuar nga Ministria e Mjedisit. (Kodi III.1.C) dhe b) Licence per Veprimtaritë e tjera profesionale lidhur me ndikimin në mjedis (Kodi III.2.B). Ne zbatim te nenit 46 të VKM 914/2014 (Kualifikimi i ofertuesve), pika 1 ku citohet se: Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme të autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese. Në këtë kuadër, KSHA vlerëson se kualifikimi i ofertës së paraqitur nga OE MEDITEL Shpk, nga KVO është sipas përcaktimit të nenit 46, pika 1 e VKM 914/2014 dhe për pasojë pretendimet e ngritura nga OE VALE RECYCLING Shpk, nuk qendrojnë [...]”

II.8.Në datën 12.02.2020, operatori ekonomik ankimues “V.A.L.E Recycling” sh.p.k., ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, me të njëjtin objekt me ankesën e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

II.9.Në datën 28.02.2020, autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr.594/7prot. datë 25.02.2020, ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin e kërkuar në lidhje me procedurën e prokurimit të sipërcituar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, informacionit të autoritetit kontraktor dhe kërkesave të ankimuesit,

Arsyeton:

III.1.Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “V.A.L.E Recycling” sh.p.k. mbi skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi me arsyen : *“Ne baze te Vendimit nr.424/3 prot.,date 21.01.2020 te AK, Operatori Ekonomik skualifikohet nga procedura me objekt "Trajtimi i Mbetjeve Spitalore anatomike te lengeta dhe te ngurta per QSUNT per 12- muaj" per shkak se oferta e paraqitur nga ky OE nuk permbush kerkesat e DST, PIKA 2.3 "Per kapacitetin teknik" germa c. Landfilli i Bushatit (menaxhim i te cilit behet nga Subjekti BECKER ALBANIA) me te cilin OE "V.A.L.E Recycling"sh.p.k ka nenshkruar kontate per depozitimin e mbetjeve spitalore asgjesim i te cilave behet me incenerim nuk eshte i pajisur me leje mjedisore konform legjislacionit ne fuqi.”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1.Në pikën 2.1.a shtojcës 7, “Për kapacitetin ligjor/profesional”, në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

“ a) Leje mjedisore e tipit A e leshuar nga Ministria e Mjedisit. (Kodi III.1.C)”

III.1.2.Në pikën 2.3.c. shtojcës 7, “Për kapacitetin teknik”, në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

“ c) Te kete leje nga Bashkia per depozitimin e produkteve që dalin nga përpunimi.”

III.1.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike në përmbushje të kriterëve të sipërcituar, operatori ekonomik ankimes, “V.A.L.E Recycling” sh.p.k, ndër të tjera ka dorëzuar:

- Kontratë Nr.55 prot datë 21.03.2019, lidhur ndërmjet “Ndërkomunale Bushat” sha dhe operatorit ekonomik “V.A.L.E Recycling” sh.p.k. me objekt: *“Shoqëria dhe Klienti dëshirojnë të hyjnë në një marrëdhënie kontraktuale në të cilën shoqëria pranon të depozitohen beturinat urbane të praueshme në landfill nga ose në emër të klientit dhe klienti do të lëvrojë një sasi kontraktuale të mbeturinave urbane të pranueshme dhe do të paguajë shoqërinë për depozitimin e këtyre mbeturinave”,* shoqëruar me dokumentacionin përkatës.
- Kontratë Shërbimi datë 18.04.2017 lidhur ndërmjet shoqëria Ndërkomunale Bushat sha në cilësinë e porositësit dhe shoqëria Becker Albania sha në cilësinë e operatorit me objekt: *“Objekti i kësaj kontrate është përcaktimi i kushteve midis palëve për dhënien në përdorim të landfillit të bushatit, operatorit dhe realizimit prej tij të shërbimeve të depozitimit, administrimit, menaxhimit, përpunimit dhe riciklimit të mbetjeve të ngurta urbane në landfillin e bushatit. Shërbimet e depozitimit, administrimit , menaxhimit përpunimit dhe riciklimit të mbetjeve të ngurta urbane në landfillin e bushatit merren përsipër të kryhen prej operatorit në përmbushje të kushteve të kësaj kontrate ”*
- Leje mjedisore e tipit A, kodi III.1.C, Incenerimi i mbetjeve të rrezikshme në një instalim incenerimi, lëshuar nga QKB për operatorin ekonomik “V.A.L.E Recycling” sh.p.k, shoqëruar me aktmiratimin përkatës.

III.1.4. Në nenin 46, pika 1 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”* Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.”*

III.1.5. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërituar, KPP konstaton se operatori ekonomik “V.A.L.E Recycling” sh.p.k. ka dorëzuar në përputhje me kriterin kualifikues dokumentacion lidhur me një landfill të licensuar nga organet kompetente shtetërore, për depozitim të produktit final që del nga përpunimi i mbetjeve spitalore, si dhe ka paraqitur lejen mjedisore të tipit A për incenerimin e mbetjeve të rrezikshme. KPP gjykon se operatori ekonomik ka përmbushur kërkesat në kriterin e vecantë të kualifikimit duke dëshmuar se disponon një landfill në një nga format e lejuara ligjore për depozitim të produktit final. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Komisioni thekson se autoriteti kontraktor në asnjë rast nuk ka kërkuar në dokumentat e tenderit që landfilli duhet të jetë i pajisur me lejen mjedisore sipas legjislacionit në fuqi. Në këto kushte, Komisioni gjykon se skualifikimi i operatorit ekonomik “V.A.L.E Recycling” sh.p.k. është bërë kundërshtim me nenin 55, pika 2 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, i cili parashikon *“2. Autoriteti kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme, për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit.”*

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik “V.A.L.E Recycling” sh.p.k. qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “V.A.L.E Recycling” sh.p.k. mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Medi - Tel” sh.p.k., Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik ankimes ka ofertuar me vlerë më të ulët kundrejt operatorit për të cilin paraqet pretendime për kualifikim, duke mos pasur një interes të ligjshëm të ankohet për operatorët e renditur sipër tij, referuar vlerës ekonomike.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik “V.A.L.E Recycling” sh.p.k., mbi ofertën e operatorit ekonomik “Medi - Tel” sh.p.k., nuk do të merret në shqyrtim

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “V.A.L.E Recycling” sh.p.k., për procedurën e prokurimit “*Kërkesë për propozim – Marrëveshje kuadër*”, me objekt “*Trajtimi i mbetjeve të rrezikshme spitalore, anatomike të lëngëta dhe të ngurta*” për QSUNT, për 12 muaj”, me nr. REF-45894-12-10-2019, me vlerë të pritshme të kontratës 2,700,000 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 30.12.2020, nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.
2. Të anulohet vendimi e autoritetit kontraktor mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “V.A.L.E Recycling” sh.p.k. dhe të korrigojë shkeljet duke e kualifikuar këtë operator ekonomik.
3. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “V.A.L.E Recycling” sh.p.k.
5. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 177 protokoli Datë 12.02.2020;

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha